



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 291 Prot.

Tiranë, më 09.02.2026

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 35 , datë 09.02.2026

“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR ME OBJEKT MONITORIMIN E ECURISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL, NË INSTITUCIONET E SISTEMIT TË SHËRBIMIT CIVIL: INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE; INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES VENDORE NË NIVEL QARKU DHE INSTITUCIONET E PAVARURA, PËR VITIN 2026”.

Në zbatim të nenit 11, pika 1, dhe nenit 14 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregullores “Për procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 82, dt. 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026” ,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar me objekt administrimin e të dhënave gjatë monitorimit të zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, për vitin 2026.

2. Inspektorët në përbërje të Drejtorisë së Mbikëqyrjes; Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ si dhe të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, si njësi organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, do të kryejnë këtë proces, sipas ndarjes së institucioneve bazuar në tipologjinë e tyre, në këtë mënyrë:

• **INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES VENDORE:**

- | | |
|----------------|--|
| - Granit Bajri | Qarku Kukës: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| | Qarku Shkodër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Antea Kabali | Qarku Lezhë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |

- | | |
|---------------------|---|
| - Eros Hoxha | Qarku Dibër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Have Brahollari | Qarku Durrës: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Sabina Liço | Qarku Tiranë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Ledina Zhupa | Qarku Elbasan: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Françeska Doksani | Qarku Fier: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Inesa Çani | Qarku Berat: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Zamira Mujali | Qarku Korçë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Alda Xhaxhiu | Qarku Vlorë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Erion Mata | Qarku Gjirokastër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse |

• INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETETËRORE

- | | |
|---------------------|--|
| - Antea Kabali | Këshilli i Ministrave dhe institucionet e varësisë ; |
| - Sabina Liço | Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë; |
| - Françeska Doksani | Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë; |
| - Zamira Mujali | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë;
Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe institucionet e varësisë; |
| - Have Brahimllari | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësisë;
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashme dhe institucionet e varësisë; |
| - Alda Xhaxhiu | Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe institucionet e varësisë; |
| - Inesa Cani | Ministria e Arsimit dhe institucionet e varësisë; |
| - Erion Mata | Ministria e Financave dhe institucionet e varësisë; |
| - Eros Hoxha | Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e varësisë; |
| - Granit Bajri | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet e varësisë; |
| - Ledina Zhupa | Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësisë;
Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe institucionet e varësisë. |

• INSTITUCIONET E PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ

- | | |
|-----------------|--|
| - Erion Mata, | Administrata e Kuvendit;
Kontrolli i Lartë i Shtetit;
Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë; |
| - Alda Xhaxhiu, | Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
Instituti i Statistikave; |

- Inesa Cani Autoriteti për të Drejtën e Informimit Mbi Dokumentet e ish të Sigurimit të Shtetit;
Avokati i Popullit;
Autoriteti i Mediave Autovizive;
Autoriteti i Konkurrencës;
Instituti i Studimeve Për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

- Eros Hoxha Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
Komisioni i Prokurimit Publik;

- Ledina Zhupa Këshilli i Lartë Gjyqësor;
Administrata e Presidentit;
Gjykata Kushtetuese;

3. Në rast se do të vlerësohet e nevojshme, për shkak të volumit të punës që do të paraqitet gjatë këtij procesi, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioneri mund të ngarkojë anëtarë të tjerë me detyra të posaçme, nga stafi i Sekretariatit, për të mbështetur inspektorët të cilët janë ngarkuar nominalisht me detyra specifike në këtë urdhër.

4. Inspektori i ngarkuar për secilin institucion sipas këtij urdhëri, në vijim, për të gjithë vitin kalendarik 2026, do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, duke vendosur komunikimin me njësitë përgjegjëse përkatëse, përmes e-mailit zyrtar, apo mjeteve të tjera ligjore të komunikimit.

5. Periudha dhe afati i mbikëqyrjes, drejtimet e mbikëqyrjes. metodologjia e punës si dhe procedurat që do të ndiqen për zbatimin e këtij urdhëri do të jenë sipas Programit të Punës që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

6. Në këtë proces do të përfshihen raportime në kohë reale nga subjektet e përfshira në këtë urdhër, për të gjitha institutet e rregulluara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe do të verifikohet çdo e dhënë e ardhur në adresë të Komisionerit. Përpunimi i këtyre të dhënave dhe raportimi i tyre nga inspektori përkatës, do të jenë nëpërmjet një

relacioni, si përmbledhje periodike 3-6-9 mujore e situatës dhe në përfundim të vitit kalendarik do të hartohet relacioni përmbledhës përfundimtar .

Nëse evidentohen problematika, sa i takon të dhënave të mbledhura apo rasteve të tjera që mund të dalin gjatë këtij procesi, inspektori përkatës duhet të raportojë menjëherë nëpërmjet një informacioni dërguar drejtorit që do të monitorojë këtë proces, duke konstatuar problematikën dhe duke evidentuar rrugët për mënyrën e zgjidhjes. Nëse vlerësohet e arsyeshme nga Komisioneri, pas verifikimit, procesi mund të kalojë në mbikëqyrje të thelluar.

7. Të dhënat e kërkuara do të jenë sipas formatit të tabelave që janë bashkëlidhur këtij urdhëri, si aneks i tij. Këto të dhëna do të mblidhen dhe përpunohen në vijimësi, ndërsa çdo 3 muaj do të raportohen, në mënyrë të përmbledhur me relacion shpjegues pranë drejtorit të ngarkuar me këtë proces. Relacionet do të përcillen nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm pranë Komisionerit.

8. Në rast se, në të dhënat e raportuara nga institucionet, të dërguara pranë Komisionerit nëpërmjet postës elektronike apo postës zyrtare, evidentohen parregullsi, situata duhet të verifikohet në vend në subjektin përkatës nga inspektori i ngarkuar, i cili do të pajiset me një autorizim të veçantë për këtë proces.

9. Inspektorët do të ndjekin informacionet në kohë reale, në lidhje me proceset e rekrutimit që zhvillohen në këto njesi, duke evidentuar pozicionin për të cilin konkurrohet, numrin e pjesëmarrësve në konkurim, llojin e procedurës së përdorur dhe problematikën nëse ka. Gjithashtu do të ndiqen në kohë reale të gjitha aktet apo veprimet administrative që dalin në zbatim të ligjit nr. 152/2013 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të gjitha institutet e ligjit sipas programit të punës së miratuar, bashkëlidhur këtij urdhëri.

10. Në përfundim të të gjithë procesit të mbikëqyrjes, Drejtori i ngarkuar me këtë proces, do të përgatisë raportin përmbledhës lidhur me situatën e shërbimit civil në institucionet e monitoruara, ku do të evidentohen gjetjet për të gjitha subjektet e përfshira në këtë urdhër, duke propozuar edhe detyra konkrete për rregullimin e gjendjes së administrimit të shërbimit civil. Në këtë material do të propozohet edhe ecuria e procesit të mbikëqyrjes për vitin pasardhës, duke evidentuar institucionet problematike dhe institutet e ligjit ku duhet të përqëndrohet mbikëqyrja, ç’ka do të shërbejë edhe si dokument për të hartuar planin vjetor të punës së institucionit për vitin pasardhës.

11. Për koordinimin dhe menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së orientuar për monitorimin e situatës së shërbimit civil në institucionet e shërbimit civil, ngarkohet Drejtori i Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, i cili do të jetë përgjegjës për respektimin e afatit të raportimit; për administrimin e të gjitha akteve me të cilat do të raportojnë inspektorët dhe për përcjelljen

e tyre pranë Drejtorit të Përgjithshëm, i cili do të marrë masat për të përgatitur raportin përfundimtar të vlerësimit, që do të miratohet nga Komisioneri.

12. Me këtë urdhër dhe tabelat pjesë përbërëse të tij, duhet të njihen të gjithë inspektorët e ngarkuar për ndjekjen e procesit, duke i vënë në dispozicion një kopje të aktit.

13. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes, dhe Drejtori i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, inspektorët sipas pikës 2 të këtij urdhëri, si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për të njoftuar punonjësit e përfshirë me zbatimin e këtij urdhëri, si dhe për të mbështetur procesin në drejtim të sigurimit të fondeve përkatëse dhe logjistikës.

14. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

